



Historia e Agostinos

Agostino's story

 LIDA Italia

 Billie Cejka Risnes

 Maria Hila

 5

 Shqip [sq](#) / English [en](#)



Unë quhem Agostino dhe jam 51 vjeç. Puna ime është të shpërndaj ushqime me biçikletë. Unë kam dy vajza, por flasim shumë rrallë. Unë dhe nëna e tyre nuk jetojmë më bashkë pasi jemi divorcuar.

. . .

My name is Agostino and I am 51 years old. My job is delivering food by bicycle. I have two daughters, but we hardly ever speak. Their mother and I no longer live together because we are divorced.



Unë jetoj me nënën time, sepse pas divorcit nuk përballoj dot të paguaj qira. Qiraja është shumë e shtrenjtë në këtë qytet.

. . .

I live with my mother, as I cannot afford to pay rent after the divorce. Rent is very expensive in this city.



Para disa muajsh punoja si pastrues për një kompani. Riparoja sende të prishura, transportoja kuti, dhe ndihmoja kur dikush kishte nevojë. Një ditë kompania më pushoi nga puna. Nuk e kuptova arsyen pse.

. . .

A few months ago I was working as a janitor for a company. I repaired things that were broken, carried boxes, and helped when anyone needed it. One day the company fired me. I did not understand why.



Shihja shumë njerëz që shpërndanin ushqime me biçikletë. Unë di t'i jap biçikletës, trokita në derën e një kompanie të madhe shpërndarjesh. Ata më ofruan tre euro për çdo shpërndarje. Fitoj 40 euro në ditë, 60 euro nëse jam shumë me fat dhe klientët më japin bakshish.

...

I saw many people delivering food by bicycle. I can ride a bicycle, so I knocked on the door of a big delivery company. They offered me three euros for each delivery. I make 40€ per day, 60€ if I am very lucky and the customers tip me.



Nuk kam pushime të paguara, as ditë të paguara kur jam i sëmurë, pothuajse nuk kam fare të drejta. Nuk mendoj se kjo është e drejtë, por më duhet puna. Shumica e punëmarrësve të tjerë janë emigrantë nga e gjithë bota.

. . .

I get no paid holiday, no sick pay, hardly any rights at all. I do not think that is right, but I need the job. Most of the other employees are immigrants from all over the world.



Shumë shpërndarës lëndohen në aksidente çdo ditë. Më pas, kur një shpërndarës 25 vjeçar u godit nga një makinë dhe vdiq, autoritetet filluan të na vinin re. Sa keq që atij iu desh të vdiste para se kjo të ndodhte.

...

Many delivery people are injured in accidents every day. Then, when a 25-year-old deliveryman was hit by a car and died, the authorities started noticing us. It is a shame he had to die before that happened.



Së bashku me shpërndarës nga kompani të tjera, ndoqa një kurs për të drejtat e punëmarrësve pranë një qendre vendore. Ata na ofruan këshillim ligjor pa pagesë. Ne u përpoqëm që të merrnim më shumë vëmendje dhe të drejta.

. . .

Together with delivery people from other companies, I took a course on workers' rights with a local union. They offered us legal advice free of charge. We struggled to get more recognition and rights.



Pas një kohe të gjatë, puna jonë e fortë u shpagua. Një kompanie të madhe shpërndarjesh iu desh të paguante një gjobë të majme dhe t'u jepte punëmarrësve punë të përhershme. Ishte hera e parë që kjo ndodhte në mbarë botën. Duket se gjërat po fillojnë të përmirësohen.

. . .

After a long time all our hard work paid off. One big delivery company had to pay a huge fine and to give workers permanent jobs. It was the first time that had happened anywhere in the whole world. It looks like things are starting to improve.



LIDA Stories

lidastories.net

Historia e Agostinos

Agostino's story



LIDA Italia



Billie Cejka Risnes



Maria Hila (sq)

